



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Kancelaria Generalnog Sekretara /Office of Generaly Secretary

DATË/A:	25.01.2018
REFERENC-Ë:	ZSP - 100/2018
PËR/ZA/TO:	Komuna Deçan
CC:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Deçanit për Taksat për Leje Ndërtimore për vitin 2018 me Nr.Protokolli 307/18 të datës 22.01.2018

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 22.01.2018 me numër protokolli 307/18, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës për vitin 2018 nga Komuna e Deçanit (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit e llogaritur nga Komuna është **2.00 €/m<sup>2</sup>** (dy euro për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 te UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja te banimit, konform formulës se përcaktuar ne nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat për lëshimin e lejes së ndërtimit në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1